



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. 2752 Prot.

Patos, më 28 08 /2026

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në pjesën V “Kontratat” dhe kreu VI “Qiraja” të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 62, datë 26.09.2025 pika 3 “Për miratimin e procedurës për marrjen me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar “Sotir Çapo”, për shkak se jemi në fazën e përfundimit total të punimeve dhe marrjes në dorëzim të objektit të shkollës “Sotir Çapo”, bashkia Patos shpall procedurën me objekt **“Marrje me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar “Sotir Çapo”, në përputhje me kriteret e mëposhtme:**

1. Ndërtesa duhet të ketë kushte optimale infrastrukture.

Ndërtesa të jetë e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor për ciklin e ulët (klasa 1-5) me një numër prej 61 (gjashtëdhjetë e një) nxënës dhe stafin pedagogjik për një periudhë të parashikuar 45 ditore mujore nga nënshkrimi i kontratës. Të jetë ndarë në ambiente përkatëse për pesë klasat dhe pjesën e stafit pedagogjik, minimalisht 200 m² me qëllim plotësimin e nevojave bazë për zhvillimin e procesit mësimor.

2. Dokument pronësie, kontratë me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe të ketë furnizim me ujë.

3. Vendndodhja e ndërtesës të ketë një distancë jo shumë të largët nga qendra e fshatit Zharrëz, Njesia Administrative Zharrëz.

Të interesuarit të paraqesin dokumentacionin e kërkuar pranë bashkisë Patos, brenda datës 09.09.2026, ora 16:00.

Ky njoftim duhet të publikohet në stendat e afishimit publik të bashkisë Patos dhe në faqen zyrtare të institucionit.

KRYETAR

Fation Duro

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR**

Ina Sauli